



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 63, datë 28.03.2025

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN GËZIM SPAHIU”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar (në mungesë)
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar (në mungesë)

në mbledhjen e datës 28.03.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Gëzim Spahiu”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacionin shoqërues nr. 1079 prot., datë 27.03.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatoren zonjën Arta Mandro, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, Këshilli shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.

2. Në datë 20.03.2025, me nr. 1008/1 prot., pranë Këshillit është administruar shkresa nr. 2918 Prot./D.M., datë 18.03.2025, *“Lidhur me kërkesën e prokurorit Gëzim Spahiu për veprimtari jashtë funksionit”*, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me anë të së cilës është përcjellë edhe shkresa *“Kërkesë për autorizimin e veprimtarisë jashtë funksionit të prokurorit”* e paraqitur nga prokurori Gëzim Spahiu.

3. Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë, si dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se, zoti Spahiu kërkon nga Këshilli, autorizimin për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit si *ekspert me ftesë të qendrës “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” në kuadër të projektit “People GBV/DV”, “Angazhimi pro aktiv në mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit për viktimat dhunës me bazë gjinore dhe bazë familjare”, që do të zbatohet nga qendra QNLQ, me mbështetjen e Ambasadës së Vendeve të Ulta.*

4. Projekti përfshin hartimin e një manuali mbi përdorimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunë familjare dhe do t’u vijë në ndihmë prokurorëve për ndjekjen penale të veprave të tilla. Z. Spahiu thekson se ky angazhim shtrihet përgjatë muajve Mars-Prill 2025 (jashtë orarit zyrtar dhe/ose në ditë pushimi) dhe se renumeracioni/pagesa respektive konsiston në një total prej treqind (300) euro bruto. Projekti në vijimësi përfshin edhe ftesën për të qenë ekspert trajnues për Oficerët e Policisë Gjyqësore, për 1-5 aktivitete trajnuese në total, përgjatë periudhës Prill-Nëntor 2025, me një pagesë bruto prej tre qind (300) eurosh bruto, për çdo ditë trajnimi. Prokurori Gëzim Spahiu, po ashtu referon se ka ftesë nga “QNLQ” edhe për të qenë ekspert në përgatitjen e një skede monitorimi për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore, përmes monitorimit të seancave gjyqësore etj., veprimtari jashtë funksioni, për të cilën thekson se shtrihet përgjatë dy (2) ditëve pune të muajit mars 2025, kundrejt një kompensimi prej katërqind (400) euro bruto në total.

5. Sipas kërkesës, angazhimi në fjalë përfshin:

- Punë kërkimore ligjore dhe përgatitje të manuali, (jashtë orarit zyrtar dhe/ose në ditë pushimi), gjatë periudhës mars-prill 2025, kundrejt një shpërblimi prej 300 euro bruto në total;
- Angazhimi si ekspert trajnues për oficerë të policisë gjyqësore përgjatë periudhës Prill - Nëntor 2025, për 1-5 aktivitete trajnuese në total, me një pagesë bruto prej tre qind (300) eurosh bruto, për çdo ditë trajnimi;
- Angazhimi si ekspert në përgatitjen e një skede monitorimi për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore, në 2 ditë pune, gjatë muajit mars 2025, kundrejt një kompensimi prej katër qind (400) euro bruto në total.

6. Trajnimet janë parashikuar të kryhen në periudhën mars – nëntor 2025. Sipas kërkesës vlera e pagesës për kryerjen e këtyre trajnimeve citohet në pikën katër të këtij Vendimi.

7. Kjo kërkesë shoqërohet edhe nga shkresa me nr. 2918 Prot, datë 18.03.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, përmes të cilës Drejtuesi z. Kreshnik Ajazi shprehet se:

“Në vlerësimin tim si drejtues i Prokurorisë, angazhimi i prokurorit Gëzim Spahiu në këto veprimtari të kufizuara jashtë funksionit, gjithsej 3-7 ditë pune, në harkun kohor Mars-Nëntor 2025, nuk cënon mbarëvajtjen e punës së tij në këtë prokurori. Lidhur me ngarkesën në punë, rezulton se aktualisht ajo është me e ulët se mesatarja e seksionit ku ai bën pjesë. Gjithashtu informoj se përgjatë vitit të fundit zoti Spahiu ka përmbushur në kohë detyrat e caktuara dhe nuk ka marrë ulje ngarkese në punë.”

8. Bashkëlidhur kërkesës së z. Gëzim Spahiu, gjendet edhe komunikimi nëpërmjet postës elektronike të drejtoreshës ekzekutive të “QNLQ”, Av. Aurela Bozo, datë 26 shkurt 2025, ku paraqitet ftesa drejtuar prokurorit Spahiu, për t’u bërë pjesë e projektit si ekspert, po ashtu edhe komunikimi me Koordinatorin e Projektit, znj. Diana Zebi, i datës 10 mars 2025, ku saktësohen periudhat e angazhimit në veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorit.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit prokurori Gëzim Spahiu nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

10. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj.

11. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:

- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohej sipas ligjit.
- nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.

12. Këshilli vlerëson se, kërkesa e prokurorit për të ushtruar veprimtari jashtë funksioni sipas objektit të saj është në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenet 4, 5 dhe 6 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e



qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”,

VENDOSI:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Gëzim Spahiu si Ekspert në kuadër të projektit “People GBV/DV”, “Angazhimi pro aktiv në mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit për viktimat dhunës me bazë gjinore dhe bazë familjare”, që zbatohet nga qendra “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”.
2. Ky vendim i njoftohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe prokurorit Gëzim Spahiu.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 28.03.2025.

ZV/KRYETAR

Erind Germenji

